



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 24.03.2025
Numër Protokolli: 2189/2025

A.nr.174/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës A.nr.174/2025 të datës 22.01.2025, të parashtruar nga ankuesja F.B-Z, kundër organit të punësimit/Ministria e Drejtësisë, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 24.03.2025 mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës A.nr.174/2025 të datës 22.01.2025, të parashtruar nga ankuesja F.B-Z.

A r s y e t i m

Ankuesja, F.B-Z (*më tej referuar vetëm* Ankuesja), kandidate për pranim sipas Konkursit me numër Reference RN0015603, të shpallur më datë 24.10.2024 nga Ministria Drejtësisë, për pozitën e punës “*Drejtor i Ekzekutiv*” në Agjencinë për Ndihme Juridike Falas, më datë 22.01.2025, ka parashtruar ankesë me numër protokolli 457/2025 të regjistruar nën shenjën A.nr.174/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me shpalljen dhe vlerësimin e kësaj procedure rekrutimi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, si dhe pretendimeve ankimore të ankuesit ka gjetur se në këtë çështje juridike administrative janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ, **sepse:**

Nga provat e administruara të lëndës rezulton se Ministria e Drejtësisë, më datë 24.10.2024 ka shpallur Konkursin publik me numër reference RN00014603, për pozitën e Kategorisë së Lartë Drejtuese, atë të *Drejtorit Ekzekutiv* në Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas, ku afati për aplikim ka qenë nga data 25.10.2024 deri më 23.11.2024.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar shtatë (7) kandidatë, ndërsa kriteret i kanë plotësuar dhe kanë hyrë në listën e ngushtë tre (3) kandidatë, në mesin e tyre edhe ankuesja, mirëpo sipas Njoftimit me numër protokolli të datës 23.12.2024, të Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë, rezulton se procedura e rekrutimit për pozitën e punës *Drejtor Ekzekutiv* në Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas është anuluar, sepse e njëjta ka përfunduar pa të paktën dy (2) kandidatë fitues të vlerësuar mbi pragun minimal të shtatëdhjetë për qind (70 %) të pikëve të përgjithshme të vlerësimit.

Ankuesja, ankesën e ka parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, mbi pretendimet ankimore për shpalljen e konkursit dhe vlerësimin e kësaj procedure rekrutimi, duke theksuar se mos vendosja e kriterëve arsimore apo Fakultetit Juridik, e bënë këtë shpallje të jetë në kundërshtim me përshkrimin e detyrave të punës, pyetjet e testit me shkrim janë hartuar gabimisht sepse janë bazuar në dispozita ligjore të shfuqizuara, dhe si rezultat i tyre Komisioni i Pranimit nuk ka arritur të garantojë një proces të drejtë dhe të mbështetur në ligjor, ashtu që e njëjta kërkon nga Këshilli që të shqyrtoj dhe monitoroj procesin e rekrutimit për pozitën *Drejtor Ekzekutiv* në Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas.

Kolegji i Këshillit, ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankuses të parashtruara si në ankesë, thekson faktin e lartë theksuar se Divizioni i Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë, përmes Njoftimit me të datës 23.12.2024, ka njoftuar kandidatët për përfundimin/anulimin e procedurës së rekrutimit sipas konkursit me numër reference RN00015603, për pozitën e punës *Drejtor Ekzekutiv* në Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas, ngase e njëjta ka përfunduar pa të paktën dy (2) kandidatë fitues të vlerësuar mbi pragun minimal të shtatëdhjetë për qind (70 %) të pikëve të përgjithshme të vlerësimit, dhe se duke pasur parasysh se ankesa e ankuses është ngritur mbi pretendimet ankimore për shkelje ligjore dhe ri shpalljen e procedurës së njëjtë të rekrutimit, Kolegji i Këshillit vlerëson se objekti i kësaj ankese është bërë i pamundur apo i kotë dhe për rrjedhojë konstaton se në rrethanat e rastit konkret janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 104 ku përcaktohet se: ***“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”***.

Kështu që nën rrethanat e mësipërme dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative,

Kolegji i Këshillit vendosi të përfundoj procedimin administrativ të filluar sipas ankesës me numër A.nr.174/2025, të datës 22.01.2025, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.174/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses F.B-Z;
- Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë; si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.